

**V E N D I M**  
**Nr. 596, datë 13.11.2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE  
MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paragrafi i dytë i pikës 2, të seksionit I, në vendimin nr.194, datë 22.5.1999, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

“- Paga e grupit II “2”

Me shkollë të mesme pedagogjike;

Me shkollë të mesme profesionale, ku fitohet specialiteti për mësuesi;

Diplomë mbi shkollën e mesme.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2000, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**